

Valdet HYSENAJ
PROF. ANDULLAH ZYMERI SUDIUES VËSHTRIMQARTË I
LEKSIKUT TË SHQIPES

Abstrakti: Gjuhën shqipe së fundi e pasuroi edhe **prof. Avdullah Zymberi** me veprën e tij: “ **Fjalor popullor**”, me rreth 20.000 fjalë, botuar nga MASHT, Prishtinë, 2014, me ç’rast autori përmes kërkimeve të pasurisë leksikore të gjuhës dhe të sinonimisë së saj, në terren, gjurmoi e përqoki (qëntoi), mbledhi dhe botoi fjalët si njësi leksikore dhe leksikun, tërësinë e fjalëve, nga ndërtimi, nga kuptimi, nga shtresimi i mundshëm etj., duke dhënë njëherësh edhe sqarime shtesë për secilën veç e veç.

Studiuesi ynë, si edhe shumë pararendës të tjerë, me të drejtë kishte parë se një mundësi e gjerë për ta pasuruar fjalorin e gjuhës shqipe me njësi të reja leksikore qëndronte në thesarin e çmueshëm të të folmeve krahinash të ndryshme të truallit të shqipes.

Edhe prof. Zymberi ndoqi këtë ecuri të hulumtimeve gjuhësore, duke e pasuruar kështu shkencën mbi fjalën me rreth 20.000 fjalë populllore, të cilat mund të gjejnë zbatim dhe integrim në një numër të madh shkencash si p.sh. në fonetikë, stilistikë, onomastikë, teori të komunikimit, sociosemiotikë, psikologji, antropologji, retorikë, semantikë, medie, arkitekturë, shkencat e letërsisë e shumë të tjera.

Me kompetencë shkencore prof. Zymberaj, duke herrur terminologjinë burimore thadroi një pasuri të veçanta të gjuhës shqipe, bazuar edhe në shtresimet kohësore dhe fondin e trashëguar të fjalësisë si një tharm të domosdoshëm në pasurimin e mëtutjeshëm të filologjisë dhe gjuhësisë shqiptare.

Përmes fjalëkrijimeve të arkivuara në këtë fjalor mëtojmë që prof. Zymberaj ta paraqesim si mbajtës, mbledhës, kërkues, memorizues dhe fjalëformues të fjalës burimore shqipe, gjë që mund të jetë edhe fjalëdhënës i fjalorit të gjuhës së sotme shqipe.

Fjalët kyçe: gjuha shqipe, fjalor, leksik, përqok, thesar.

Kërkimtar i përkushtuar i thesarit të leksikut të shqipes

Hyrje

Përpjekjet për hartimin e një fjalori të mirëfilltë kombëtar të gjuhës shqipe nuk munguan asnjëherë, patriotët e shquar e mendjendritur si **Nikollë Keta** e **Theodor Kavalioti**, që në shek. XVII bënë përpjekje për hartimin e një fjalori kombëtar shpjegues të shqipes, si kundërpërgjigje kundrejt rrezikut që i kanosej popullit tonë në përgjithësi dhe gjuhës shqipe në veçanti.

Edhe shek. XVIII shënon përpjekjet e hartuesve të fjalorëve të gjuhës përmes **A. Vajes** e **A. Ulqinakut**, për të vazhduar në shek XIX me **K. Kristoforidhin** e **S. Frashërin**. (Buda, A. *Fjalori i gjuhës shqipe*, 1980, faq. 3)¹. Dosido, këto dhe shumë përpjekje të tjera mbetën të parealizuar. Viti 1954 shënon arritjen e parë me botimin e fjalorit shpjegues kombëtar “ **Fjalori i gjuhës shqipe**” i Institutit të Shkencave me kryeredaktor **Kristaq Cipon** me bashkëpunëtorët **Eqrem Çabej**, **Mahir Domi**, **Anton Krajni** dhe **Osman Myderizi**, (Cipo K.1954)² duke i hapur rrugë njësimi të gjuhës letrare kombëtare. Më pas nuk reshtën botimet e nduarnduarshme të fjalorëve të cilat i ndihmuan arritjet e reja e më të reja të gjuhësisë shqiptare.

“Lufta për gjuhën letrare shqipe, për *mësimin* e *lërimin* e lirë të saj, për *njësimin*, *pastrimin* dhe *pasurimin* e saj, u bë një nga qëllimet e mjetet kryesore të Lëvizjes së gjerë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare” - shkruan Androkli Kostallari.

Fjalori popullor i prof. Zymerit, vlerë shumëdimensionale gjuhësore

Gjuhën shqipe së fundi e pasuroi edhe **prof. Avdullah Zymberi** me veprën e tij: “ *Fjalor popullor*”, me rreth 20.000 fjalë, botuar nga MASHT, Prishtinë, 2014, me ç’rast autori përmes kërkimeve të pasurisë leksikore të gjuhës dhe të sinonimisë së saj, në terren, gjurmoi e përqoki (qëmtoi), mblodhi dhe botoi fjalët si njësi leksikore dhe leksikun, tërësinë e fjalëve, nga ndërtimi, nga kuptimi, nga shtresimi i mundshëm etj., duke dhënë njëherësh edhe sqarime shtesë për secilën veç e veç (Zymberi, A. 2014)³.

Prof. Zymberaj la pas një veprimtari të rëndësishme, tejet të rëndësishme në disa fusha të kërkimeve e të studimeve të gjuhës shqipe.

Vendi parësor i këtyre gjurmimeve i përket leksikografisë dhe dijeve të tjera simotra të saj si p.sh.: leksikologjisë, frazeologjisë, dialektologjisë, drejtshqiptimshmërisë etj.

Studiuesi ynë, si edhe shumë pararendës të tjerë, me të drejtë kishte parë se një mundësi e gjerë për ta pasuruar fjalorin e gjuhës shqipe me njësi të reja leksikore qëndronte në thesarin e çmueshëm të të folmeve krahinash të ndryshme të truallit të shqipes.

Ai, për ta qëmtuar këtë materie të pasur gjuhësore dhe jo vetëm gjuhësore, hap të parë veprimi e pati hulumtimin në terren.

Zatën kjo ecuri veprimi (gjurmimi në terren) qe një nga kërkesat e rilindësve për ta rirë gjuhën me zhvillime të pasura të gurrës burimore, por edhe qëndrim i studiuesve në vijimësi.

Edhe prof. Zymberi ndoqi këtë ecuri të hulumtimeve gjuhësore, duke e pasuruar kështu shkencën mbi fjalën me rreth 20.000 fjalë popullore, të cilat mund të gjejnë zbatim dhe integrim në një numër të madh shkencash si p.sh. në fonetikë, stilistikë, onomastikë, teori të komunikimit, sociosemiotikë, psikologji, antropologji, retorikë, semantikë, medie, arkitekturë, shkencat e letërsisë e shumë të tjera.

Mund të konstatojmë se përmes këtij fjalori leksiku i shqipes është pasuruar me fjalë popullore të brumit të shqipes, të dialekteve të saj që janë përvetësuar dalëngadalë nga gjuha letrare dhe se shumë prej këtyre fjalëve janë përdorur në gjuhën e përditshme pasi ato tashmë ekzistonin në popull, që natyrisht i kanë bërë shërbime të mëdha gjuhës shqipe.

Çdo gjuhë lidhet me një bashkësi gjuhësore të caktuar: shqipja është gjuha e shqiptarëve, greqishtja e grekëve, rumanishtja e rumunëve etj. Po asnjë bashkësi gjuhësore nuk është homogjene sa ajo e shqiptarëve, sepse ata komunikojnë të gjithë me anë të gjuhës shqipe dhe kjo është gjëja kryesore që i bashkon ata⁴. Megjithatë, prof. Zymeri, për katërdhjetë vjet me radhë, përmes materies hulumtuese fjalësore shënoi edhe dallime pikëpamjesh të ndryshme fonetike, morfologjike, sintaksore, stilistike, semiologjike, pragmatike etj., duke i vjelë dhe klasifikuar me kujdes kësisoj:

- **shqiptarët që jetojnë të ndarë në krahina, qytete e fshatra** : Plavë e Guci, Krajë e Opojë, Has e Drenicë, Prizren e Gjakovë, Pejë e Tetovë, Shkup e Manastir, Gostivar e

Krajë, Dragash e Suharekë, Demjan e Celinë, Ruhot e Kishavë, Hoqë e Lipovec etj (Zymberi, A. 2014) ;

- **shqiptarët që u përkasën shtresave të ndryshme shoqërore** (fshatarë, punëtorë, intelektualë, të pasur, të mesëm, të varfër) dhe të moshave e sekseve të ndryshme (Ilir Shaqiri e Hazir Shaqiri, Qerim Zymberaj e Vake Zymberaj, Sylë Berisha e Bardhec Berisha, Ramë Shatri e Bekë Osmanaj, Tasim Miftari e dr. Nesim Miftari, prof. Adem Hulaj e Rexhep Kryeziu, shkrimtari Xhabir Ahmeti e avokati Ruzhdi Berisha etj.

Përmes shumëdimensionalitetit të fjalëve, përpos sinonimisë, antonimisë dhe homonimisë, hetojmë edhe trajtimin e shtresave shoqërore, strukturat mjedisore, mënyrat dhe rrethanat shoqërore të jetës, dëshmitë e ruajtjes së dokeve, të riteve dhe të traditës, artet vizuale si dhe qëndrimin ndaj vlerave të mirëfillta kulturore të të gjitha sferave (Zymberi, A. 2014).

Zymberaj përmes fjalorit të tij habit me faktin e përdorimit të vogël të fjalëve turke dhe huazimeve orientale, të cilat në të folmen e qyteteve dhe fshatrave kanë zënë vend në përdorimin e gjuhës së folur si fjalë tashmë të rrënjosura në të folmen tonë të përditshme. Veçojmë se në veprën dyvëllimshme të **Pjetër Bogdanit: “Çeta e profetëve”**, të botuar me 1685 ka disa turqizma (Bogdani P. 1685). Huazimet turke i hasim edhe në **“Vendimet e Kuvendit të Arbënit”** (1703). Në **“Fjalorin e gjuhës shqipe”** (1954) turqizmat përbëjnë vetëm një të shtatëmbëdhjetën e fjalësit (e glosarit) (FSHGJ, Tiranë, 1954) kurse në **“Fjalorin e gjuhës shqipe”** (1980) turqizmat përbëjnë rreth një të njëzetën e fjalësit (FSHGJ, Tiranë, 1980).

Fjalor me interes për socioonomastikën, sociolinguistikën dhe semiotikën

Në sferën e gjurmimit tonë **sociosemiotik** në fjalorin e **prof. Avdullahut** mund të gjenden shumë emërtime onomastike të cilat përmbajnë tregues jo vetëm onomastikë, porse edhe tregorë me interes **sociolinguistikë** dhe **sociosemiotikë**.

Nga kjo pikëpamje mund të thuhet se shumë antroponime sajojnë një segment të komunikimit social, i cili në rrjedhën e kohës, në pjesën dërrmuese ka pasur evoluime të ndryshme dhe e ka humbur anën burimore të semantikës së dikurshme.

Megjithëkëtë, për studimet sociolinguistike është me interes identifikimi i faktorëve shoqërorë që shërbejnë si mbështetje dhe si bindje për emërtime të këtilla.

Në antroponiminë shqiptare dikur ishte mjaft i përhapur emri mbi bazën e bishës së egër **Ujk** dhe antroponimi **Ujk-a**. Ky antroponim përdoret edhe në trajtën e gjinisë femërore **Ujkije**, sidomos në krahinat veriperëndimore të të folmeve shqipe (ku edhe i ka shënuar prof. Zymberi), gjë që do të trajtohet në fushën e antroponimisë (Hysenaj, V.(2015).

Nga ana sociolinguistike, në dijen e antroponimisë, është me interes shkencor të ndiqen shtysat sociale të vënies së emrave (**socioonomastike dhe sociosemiotike**) dhe ato janë të ndryshme aq sa janë të ndryshme edhe grupet dhe shtresat shoqërore si dhe botëkuptimet e tyre. Në emërvënien e njerëzve mund të hetohen edhe ngërthesat diatopike dhe diastatike (Mujaj, H. Prishtinë. 2011) ⁵.

Kështu, kundruar nga ana diatopike, në fjalorin në fjalë, antroponimet metaforike: **Bjeshkë, Mal,** etj. janë vënë më shumë në viset malore, atje ku rrethanat sociale të jetës ishin më të

vështira dhe imponohej edhe qëndresa fizike për t'i përballuar kushtet e jetës dhe të veprimtarisë në klimën e ftohtë të viseve të larta malore.

Do vënë në dukje se emra të këtillë nuk janë vënë në qytete dhe vendbanime urbane, porse në ato më anësore nën ndikimin **diatopik social** (Hysenaj, V. Tetovë.2015) ⁶. Edhe aspekti ndërshtresor ka reflekset edhe në fushën e antroponimisë.

Autori, si një studiues i rëndësishëm i terminologjisë popullore, tradicionalisht të pranueshme në përdorim, pas hedhjes së të dhënave të fjalorëve ekzistues, ka mbledhur me hollësi të gjitha fjalët e përdorura në popull, me të gjitha karakteristikat gjuhësore, duke filluar që nga fjalët ilire, të botuara dhe të mbledhura edhe më herët e deri në ditët e sotme, duke i plotësuar, analizuar, gjetur dhe paraqitur fjalët e duhura burimore shqipe për secilin term, madje edhe fjalë të rralla, gjithnjë duke u bazuar në dialektologjinë aktuale dhe historike dhe në historinë e leksikut duke trajtuar edhe përmbajtjet konceptore të tyre (Dhima, Th. (2014) ⁷.

Konstatime përmbyllëse

Zymeri nuk hezitoi që këtë fjalor ta pasurojë me **eufemizma**, me këtë kategori shprehjesh e fjalësh mjaft të pasura gjuhësore, në kuptimin pozitiv, duke mos lënë anash as ironinë dhe fjalët pezhorative në kuptimin negativ si ⁸ (Ibrahimi, M. (2015):

Ai kamshtremti. *Eufemizëm për djallin.*

Aj i gardhit. *E. për gjarpërin.*

Aj ju gurt goja. *E. për ujkun.*

Ai i pakryqi. *E. për djallin.*

Namët, si pjesë e folklorit, bëjnë pjesë në jetën e gjallë të popullit, të lidhura ngushtë me zakonet dhe besimet e popullit duke pasqyruar pikëpamjet përmes fjalive dëshirore në formë mallkimi:

Ja baj;t nana gja:mt e n'brez.

Ja pafsha bajrakun e zi maje ship;s!

Fjalori popullor nuk anashkalon as frazat e shkurtëra që me pak fjalë e shprehim filozofinë popullore (**urtinë popullore**).

Mae hajnin Mae hajnin ! Un po e ma po aj s'un lshon.

Ardh si gonxhe e dalsh si lule.

S'ja ka vu: kapakin vegshit (Ftj. Krajë).

Syni i çkruem s'ka t'pague (Ftj. Krajë).

Syni i zi për dja:l t'ri (Ftj. Krajë).

Aj shkon ka t'fry:n era.

Ai qi sa da e len vetin pa gja

Përmes **këngëve të kapuçave**, studiuesi ynë na e paraqet artin popullor si trashëgimi të traditës, loja kjo më popullore dhe më tërheqëse në zonën e Dukagjinit dhe më gjerë (Shala, D. (1983) ⁹. Mbas darke, e sidomos netëve të gjata të dimrit, organizohej loja e kapuçave, duke kaluar radhën në çdo shtëpi, me meshkuj të rritur e lojtarë kapuçash.

“Ky Ramizi kryehuder, e bleva per çën, e m'duli kudër”. (Maz – Has).

Të rinjtë në moshën rinore sipas zakonit fejohej, për të fejuarit kërkohet bukuria, morali, karakteri, identiteti personal, familjar, si parakusht për një martesë të lumtur. Të gjitha këto veti dhe cilësi Zymberaj i paraqet përmes **këngëve të fejesës** si:

“ Na (në qoftë se) paç bâ nusen e keçe, t’u baf:të udha lak e leçe. Vern. Prizren.

Edhe **këngët baritore**, të krijuara në gjirin e popullit të thjeshtë, të trashëguara brez pas brezi, kanë qenë ushqim për popullin tonë, këngë këto të cilat janë përcjellë deri në ditët e sotme.

Mori e mira n’ato maje rritju bacit kadaldale. (Ruhot – Pejë).

“Po bje bora sukuj – sukuj, del ne der moj nusja e bukur”.

Me mjaft elokuencë autori përdor shumësi **sinonimesh** si:

Po ta ngjeshi, po ta veshi, po ta kuçi, po ta rrapangjeshi, po ta tinglloj, po ta dhezi, po ta çepoj, po ta zdriti, po ta pshteti, po ta pingalozi, po ta rراسi, po ta paloj, po ta llulli, po ta krisi, po ta palaviti, po ta kersas, po ta llupi, po ta futi, po ta phylli nja, po ta psheshi, po ta fizlloj nja etj.

Për të gjitha fjalët dhe termat e përduror brenda njësive hyrëse është dhënë edhe fusha e përdorimit të njësive me përdorim të gjerë në gjuhësi si p.sh.: gramatikë, gjini, rasë, kohë etj., të cilat po i paraqesi përmes disa shembujsh:

Rakçua (me) fol. Rakçoj, kryen punët e shtëpisë rangatorja. (Kojë).

Riezua (me) 1. Riezuj, zbukuroj. Zbukuroj dhomën, sallën.

2. Edhe joveprori – riezua (me u) fol. Zbukurohet njeriu, kur të përmirësohet nga shëndeti.

Rishtua (me) fol. Rishtoj. 1. I mbush gotat e rakisë sërish. Na i rishtojato gota!

2. Shtie diçka të re në shtëpi.

Rrasuke –ja f.sh. –e, –et Rrasë e vogël guri (Dol – Guci).

Sikundër ka parë linguisti amerikan **E. Sapir**: “Gjuha është aktivitet i njeriut” (Çabej, E. (1978) ¹⁰.

Nga kjo del të kuptojmë se është më se e nevojshme t’i kushtohet vëmendje më e madhe problemit të ngritjes së kulturës gjuhësore, e këtë ngritje prof. Zymberaj e bëri me botimin e fjalorit të tij.

Mund të përfundojmë se kjo vepër ofron dukuri të shumta morfologjike që janë të zhvilluara jo vetëm në gjuhën shqipe dhe që meritojnë të trajtohen në të ardhmen si tipare të veçanta të gjuhës sonë.

Bibliografia

Buda. A. (1980) Fjalori i gjuhës shqipe. Zëri i Popullit. Tiranë. 14 mars 1980. faq. 3.

Zymberi. A. (2014) Fjalor popullor me rreth 20.000 fjalë. MASHT. Prishtinë.

Cipo, K. Çabej, E. Domi, M. Krajni, A. Myderizi, O. (1954) Fjalori i gjuhës shqipe. Tiranë.

Akademia e shkencave e RPSSH (1958) Fjalor Enciklopedik Shqiptar. Tiranë.

Mujaj, H. (2011) Semiotika dhe zhvillimi i saj. Prishtinë.

Hysenaj, V. (2019) Socioonomastika e Pejës. Tezë doktorate. Tetovë.

Dhima, Th. (2014) Histori e gjuhësisë. Infbotues. Tiranë.

Ibrahimi, M. (2015) Trajtesa leksiko-frazeologjike të shqipes. Interlingua. Shkup.

Shala, D. (1983) Letërsi populllore. Biblioteka universitare. Prishtinë.

Çabej, E. (1978) Hyrje në historinë e gjuhës shqipe. Prishtinë.